



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 83 regjistër (JR)
Datë 24.12.2021

Nr. 60 i vendimit
Datë 20.11.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 20.11.2024, ditën e mërkurë, ora 10:40, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUESE:

Subjekti i rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI:

Shqyrtimi i vendimit nr. 452, datë 24.09.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës, nenet A, Ç, D, Dh, E të Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, të paraqitura në ankim dhe parashtrime me shkrim, e cila përfundimisht kërkoi të mos konsiderohet subjekt i ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, prishjen e vendimit të Komisionit si të pabazuar në ligj dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si dhe në rast të shqyrtimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), të çështjes së saj të rivlerësimit, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 452, datë 24.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, është emëruar në detyrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”), më datë 20.01.2017, dhe po nga ky Këshill, më datë 10.02.2017, është caktuar në pozicion për të ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës dhe në pritje të emërimit në detyrë, znj. Hoxholli kishte plotësuar deklaratat për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, sipas shtojcave respektive të ligjit nr. 84/2016, procesi i saj i rivlerësimit i është nënshtruar shortimit në Komision dhe më pas është filluar procesi administrativ, duke njoftuar edhe subjektin e rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli.
2. Më datë 07.12.2020, me kërkesë paraprake, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., subjekti i rivlerësimit ka kërkuar mosfillimin e procedurës së saj të rivlerësimit, me pretendimin se nuk përfshihej në rrethin e subjekteve të parashikuara në nenin 179/b të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.
3. Komisioni njoftoi subjektin me anë të postës elektronike, se ka vendosur që znj. Semiramis Hoxholli duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe, lidhur me këtë vendim, mund të ushtrohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar, duke arsyetuar se:

Së pari, qëllimi i procesit të rivlerësimit nuk është të emërojë apo caktojë një magjistrat në detyrë, por të kryejë rivlerësimin kalimtar sipas Kushtetutës dhe ligjit për konfirmimin ose jo të tij në atë funksion.

Së dyti, parimet mbi të cilat zhvillohet ky proces, parashikohen shprehimisht në Kushtetutë dhe jurisprudenca së cilës i referohet subjekti për përjashtimin nga procesi i rivlerësimit, nuk cenon parimin e sigurisë juridike dhe atë të gjësë së gjykuar, i njeh të drejtat themelore të individit (jo ndaj zyrtarëve të lartë të shtetit apo funksionarëve të sistemit të drejtësisë).

Së treti, kufizimi i disa të drejtave për gjyqtarët dhe prokurorët sipas Kushtetutës dhe Aneksit të saj ka për qëllim krijimin e besimit të publikut te drejtësia dhe institucionet e reja të sistemit dhe ky qëllim realizohet përmes zbatimit drejtpërdrejt të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nga institucionet e rivlerësimit dhe jo nga institucionet e emërtesës [...].

II. Vendimi i Komisionit

- 4 Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në tri kriteret e vlerësimit, të pasurisë, figurës dhe aftësisë profesionale. Bazuar në provat e administruara, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin që subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, gjyqtare në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 452, datë 24.09.2021, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, mbi bazën e konkluzioneve si më poshtë.

4.1 Për vlerësimin e kriterit të pasurisë:

i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të tij.

iii. Pasaktësia e konstatuar në deklarin më sipër, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61, dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.

iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Semiramis Hoxholli, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

4.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:

Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm lidhur me kontrollin e figurës në formularin sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, duke fshehur përfshirjen e vëllait të saj në krimin e organizuar dhe, referuar pikës 4 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpigjet të bëjë deklarin të pasakta ose të fshehë kontaktet me persona të përfshirë

në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

4.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale:

Nga vlerësimi tërësor i aftësive profesionale, u konstatua se mangësitë e evidentuara nuk janë të tilla që të cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit apo që të kenë cenuar të drejtat e palëve në proces, në kuptim të pikave 3 dhe 5 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe, si rrjedhim, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, duke respektuar të drejtat e palëve dhe ka qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, për këtë arsye, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

III. Mbi ankimin dhe shkaqet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

5. Më datë 16.12.2021, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar ankimin kundër vendimit nr. 452, datë 24.09.2021, i cili është protokolluar në Komision me nr. {***} prot. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit.
6. Nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar:
*Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.
Riçeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen e provës së re, pyetjen në cilësinë e dëshmitarit, të tim vëllai, E. H.
Ndryshimin e vendimit nr. 452, datë 24.09.2021, korrigjuar me vendimin nr. 452/1, datë 02.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*
7. Subjekti i rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, më datë 12.11.2024, depozitoi në Kolegj parashtrime me shkrim, ku kërkoi të mos konsiderohet subjekt rivlerësimi në bazë të ligjit nr. 84/2016 dhe prishjen e vendimit nr. 452, datë 24.09.2021, korrigjuar me vendimin nr. 452/1, datë 02.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe në rast të shqyrtimit të çështjes në themel nga Kolegji, kërkoi konfirmimin e saj në detyrë. Bashkë me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Kolegj në të njëjtën datë, edhe kërkesë për heqje dorë nga thirrja në cilësinë e dëshmitarit të të vëllait, z. E. H., për arsye se marrëdhëniet familjare ndërmjet tyre janë distancuar si shkak i situatës familjare të krijuar për shkak të procesit të saj të rivlerësimit. Pavarësisht se heq dorë nga kërkesa e saj në ankim për t’u pyetur vëllai i saj në cilësinë e dëshmitarit, subjekti i qëndron kërimit të saj, të dëgjohet në seancë publike në Kolegj.

7.1. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me pretendimin se Komisioni ka përcaktuar në mënyrë të gabuar pozitën e saj në raport me procesin e rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, parashtrori se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, si pasojë e mosargumentimit në mënyrë shteruese të natyrës specifike të statusit që gëzonte znj. Hoxholli

në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, Komisioni nuk ka bërë cilësimin e saktë të situatës ligjore.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit, duke vendosur shkarkimin e saj nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

10. Në përputhje me nenin 65, pika 1¹ e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, gjithashtu dhe në rastet kur nuk jemi në kushtet e parashikuara nga neni 51 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi që çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 452, datë 24.09.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, të gjykohet në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazën e akteve të administruara në Komision, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

¹ “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit të paraqitura nga ankuesja

11. *Lidhur me pretendimin e ankueses, se Komisioni ka përcaktuar në mënyrë të gabuar pozitën e saj në raport me procesin e rivlerësimit, ajo parashtrroi se, si rrjedhojë e këtij përcaktimi, Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, si pasojë e mosargumentimit në mënyrë shteruese të natyrës specifike të statusit që gëzonte znj. Hoxholli në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, Komisioni nuk ka bërë cilësimin e saktë të situatës ligjore. Ankuesja argumenton se në nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, është parashikuar se do të jenë subjekt rivlerësimi vetëm ata persona që janë parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, duke referuar në ligjin themeltar të shtetit. Ankuesja sqaron se është caktuar në pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nga KLD-ja, duke zbatuar nenin 39, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon se i caktuari në pozicion duhet të ketë rezultate “shumë të mira” në lëndët e së drejtës administrative në Shkollën e Magjistraturës. Ankuesja sjell në vëmendje këtë argument për të sqaruar se, nëse nuk do të zbatoheshin dispozita e mësipërme për caktimin në pozicion, ajo nuk do të mund të plotësonte kriteret e parashikuara në nenin 5, pika 2, germa “a”² e ligjit nr. 49/2012 (5 vite vjetërsi). Gjithashtu, ajo shpjegon se Komisioni ka konsideruar si periudhë rivlerësimi periudhën e punës në të cilën vlerësohen aftësitë profesionale, nga 08.10.2013 - 08.10.2016, periudhë për të cilën ankuesja nuk ka dhënë vendime meritore apo jomeritorike, pasi ka qenë kandidatë për t’u bërë gjyqtare. Gjithashtu, ankuesja pretendon se në dispozitën kalimtare, në nenin 160 të ligjit nr. 96/2016, nuk është parashikuar rezultati i procesit të rivlerësimit si shkak i mbarimit të statusit, si dhe me mbarimin e mandateve të Komisionit dhe Kolegjit, kompetencat e tyre do të ushtrohen përkatësisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) dhe Gjykata Kushtetuese, ndaj nuk qëndron arsyetimi i Komisionit se organet e emërtesës nuk bëjnë rivlerësimin e subjekteve, por verifikimin paraprak të tyre.*

11.1 Kolegji konstaton se ankuesja ka depozituar në Komision një kërkesë paraprake me objekt mosfillimin e procedurës së saj të rivlerësimit, protokolluar me nr. {***} prot., datë 07.12.2020. Nëpërmjet kësaj kërkesë, në mënyrë të përmbledhur, ankuesja ka sqaruar se në datën kur ligji nr. 84/2016 ka hyrë në fuqi, nuk e ka pasur statusin e gjyqtares, kjo referuar edhe vetë nenit 160 të ligjit nr. 96/2016, i cili ka cilësuar në mënyrë të shprehur “kandidatë për magjistratë të diplomuar në vitin 2016” dhe jo gjyqtarë në detyrë. Më tej, sqaron se ky rregullim ligjor ka qenë specifik, vetëm për brezin e magjistratëve që kanë kryer Shkollën e Magjistraturës në periudhën tetor 2013 – qershor 2016. Subjekti shpjegon se kur është emëruar në detyrën e gjyqtares janë aplikuar të gjitha kriteret, të cilat duhet të aplikohen për çdo gjyqtar të ri, i cili ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të periudhës korrik - tetor 2016.

11.2 Komisioni, nëpërmjet postës elektronike, njoftoi ankuesen se duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe, lidhur me këtë vendim, mund të ushtrohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar, duke arsyetuar se praktika/stazhi si gjyqtar me emërim të përkohshëm, e cila

² “Gjyqtar në gjykatën administrative të shkallës së parë mund të emërohet shtetasi shqiptar që përmbush kriteret e mëposhtme: a) të jetë gjyqtar jo më pak se 5 vjet [...]”.

zhvillohet në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës (për ankuesen vitet 2015-2016), e vendos subjektin në kushtet e ushtrimit të funksionit dhe të qenit në detyrën e gjyqtarit ,edhe pse me emërim të përkohshëm. Për rrjedhojë, automatikisht, subjekti është në sferën e zbatimit të ligjit nr. 84/2016 dhe, si pasojë, edhe subjekt i këtij ligji. Më tej, Komisioni arsyeton se vetë ligji nr. 96/2016, i cili parashikon rregullimet transitorë në nenet 164 dhe 169 të tij për gjyqtarët dhe prokurorët, në frymën e Kushtetutës dhe në zbatim të drejtpërdrejtë të saj dhe të ligjit nr. 84/2016, e lidh qëndrimin e subjektit në detyrë dhe gëzimin e të drejtave dhe detyrimeve të gjyqtarëve me kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se znj. Semiramis Hoxholli, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ishte subjekt që duhej t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit *ex officio*.

11.3 Në shpjegimet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ankuesja ka sqaruar se ka ndjekur Shkollën e Magjistraturës në periudhën tetor 2013 – qershor 2016. Me dekretin e datës 20.11.2015, të Presidentit të Republikës, është caktuar për të kryer praktikën profesionale. Në korrik të vitit 2016, është diplomuar zyrtarisht pranë Shkollës së Magjistraturës dhe emërimin përfundimtar në detyrë e ka marrë me vendimin nr. {***} të Këshillit të Lartë të Drejtësisë më 20.01.2017, ndërsa caktimin në pozicionin e gjyqtarës pranë Gjykatës Administrative të Shkollës së Parë Tiranë, e ka marrë më 10.02.2017, me vendimin nr. {***} të po këtij Këshilli.

Në dokumentacionin e dosjes së ardhur nga Komisioni, nuk gjendeshin të administruara aktet të cilat citon ankuesja dhe, nëpërmjet të cilave, është emëruar dhe caktuar në pozicion. Gjyqtarja relatore e çështjes, bazuar në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.09.2024, i kërkoi Këshillit të Lartë të Drejtësisë të përcjellë në Kolegj aktet të cilat Komisioni i ka cituar në vendim dhe znj. Hoxholli në ankim. Në përgjigje³ të kësaj shkrese, KLGj-ja përcolli në Kolegj: **(i)** dekretin nr. 9326, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës “Për caktimin e përkohshëm të kandidatëve për magjistratë për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë”; **(ii)** vendimin nr. {***}, datë 20.01.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Për emërimin magjistrat të znj. Semiramis Hoxholli”; **(iii)** vendimin nr. {***}, datë 10.02.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin në pozicion të magjistratëve që kanë përfunduar në periudhën tetor 2013 - qershor 2016 në Shkollën e Magjistraturës”.

11.4 Sipas dokumentacionit të ripërcjellë në Kolegj nga KLGj-ja e të administruar më parë edhe në Komision, rezulton se në vitin 2013, znj. Semiramis Hoxholli është kualifikuar për të ndjekur programin 3-vjeçar të formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në profilin gjyqtare, për periudhën 2013-2016. Pas përfundimit të vitit të dytë të formimit fillestar, në vitin 2015, në bazë të nenit 19⁴ të ligjit nr. 8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”⁵ (në vijim “ligji nr. 8136/1996”), me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9326,

³ Shkresë e KLGj-së me nr. {***} prot., datë 15.10.2024.

⁴ Neni 19 i ligjit nr. 8136/1996 parashikon: “Në përfundim të periudhës së veprimtarisë teorike si dhe të stazhit paraprofesional, kandidatët emërohen provizorisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas vlerësimit të këshillit pedagogjik. Vlerësimi bëhet në katër shkallë: a) pamjaftueshëm b) mjaftueshëm c) mirë d) shumë mirë. Kandidatët që marrin vlerësimin pamjaftueshëm, nuk i nënshtrohen procesit të emërimit provizor”.

⁵ Aktualisht i shfuqizuar.

datë 20.11.2015, znj. Semiramis Hoxholli është caktuar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas kryerjes së stazhit profesional në këtë gjykatë, që përkon me përfundimin e programit 3-vjeçar të formimit fillestar, dhe pas vlerësimit të kandidatëve për magistratë të vitit të tretë, profili gjyqtar, që kanë ndjekur Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës tetor 2013 – qershor 2016, me vendimin nr. {***}, datë 20.01.2017, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendosi të emërojë “magjistrat” (gjyqtare), të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, znj. Semiramis Hoxholli. Gjithashtu, rezulton se me vendimin nr. {***}, datë 10.02.2017, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendosi të caktojë në pozicion si magistratë që ka përfunduar në periudhën tetor 2013 - qershor 2016 në Shkollën e Magjistraturës, për të ushtruar funksionin e gjyqtares, znj. Semiramis Hoxholli, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pra, ankuesja ka filluar stazhin profesional nën regjimin e ligjit nr. 8136/1996, i cili u shfuqizua me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim “ligji nr. 115/2016”) në datën 16.12.2016, ndërsa emërimi në detyrë dhe caktimi në pozicion ka vijuar me hyrjen në fuqi, në datën 22.11.2016, të ligjit nr. 96/2016, i cili me parashikimet e përcaktuara në dispozitën kalimtare (nenin 160 të këtij ligji), ka sistemuar në mënyrë të posaçme brezin e studentëve të Shkollës së Magjistraturës që përfunduan studimet në vitin akademik 2016, vit i cili korrespondon me ndryshimet kushtetuese dhe të kuadrit ligjor të reformës në sistemin e drejtësisë.

11.5 Kolegji konstaton se ankuesja është emëruar nga KLD-ja si “magjistrat” në datën 20.01.2017 dhe, po nga ky institucion, është caktuar në pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, më datë 10.02.2017. Emërimi i saj ka ndodhur në kuadrin e ri ligjor, që i përket paketës së ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë, i cili nuk u miratua në mënyrë harmonike në të njëjtën kohë. Konkretisht, në kohën e emërimit në detyrë të ankueses (20.01.2017), në datën 11.08.2016, kishte hyrë në fuqi ligji nr. 76/2016 dhe në datën 08.10.2016, kishte hyrë në fuqi ligji nr. 84/2016. Hyrja në fuqi e ligjit, i cili miratoi ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e gjeti ankuesen Semiramis Hoxholli të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës (korrik 2016), por të paemëruar nga KLD-ja si “magjistrat” (emëruar më 20.01.2017). Gjithashtu, rezulton se në datën 06.10.2016, në Kuvendin e Shqipërisë ka qenë miratuar ligji nr. 96/2016, i cili ka hyrë në fuqi në datën 22.11.2016.

11.6 Referuar ndryshimeve kushtetuese, Kolegji sjell në vëmendje nenin 136/a të Kushtetutës, i cili parashikon se: *1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre sipas ligjit. 2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj.* Pra, një shtetas shqiptar mund të emërohet gjyqtar vetëm pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak. Në rastin konkret, Komisioni ka konsideruar si subjekt rivlerësimi znj. Hoxholli që në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, kur ishte akoma studente dhe e padiplomuar. Ligji nr. 96/2016 i konsideron të kualifikuarit/studentët që ndjekin Shkollën e Magjistraturës si “kandidatë për magistratë” dhe në nenin 33 të tij, parashikon rregullat për praktikën/stazhin profesional, si për kandidatët gjyqtarë, edhe për ata prokurorë. Sipas nenit 34 të këtij ligji, ata konsiderohen sërish si kandidatë magistratë, edhe pasi janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, duke marrë titullin

“magjistrat” vetëm pas emërimit të tyre, pasi diplomohen në përputhje me kushtet e procedurat e nenit 35 të ligjit nr. 96/2016. Organi kompetent, sipas normës kushtetuese të cituar më sipër (neni 136/a) për emërimin e gjyqtarëve, ishte Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili nuk ishte krijuar⁶ ende në kohën e emërimit të ankueses si magjistrate. Në këtë periudhë transitore, kur norma kushtetuese kishte pësuar ndryshime, të cilat ishin ende të paaplikueshme për shkak të mosngritjes ende të institucioneve të reja të drejtësisë, u miratua edhe ligji nr. 96/2016, i cili përcaktoi qartazi se cilat ishin organet që do të ushtronin përkohësisht kompetencat e organeve të reja që nuk ishin krijuar ende. Neni 160 i ligjit nr. 96/2016 përcaktoi se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ushtronte disa nga funksionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në krijimin e këtij të fundit. Komisioni, në vendimin objekt shqyrtimi, ka arsyetuar: *Në dokumentacionin e administruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, rezulton se subjekti ka pasur emërim të përkohshëm si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 13.11.2015, të ish-KLD-së dhe “emërimi i përkohshëm” është një institut që parashikohet edhe nga ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, i ndryshuar, edhe nga ligji i ri nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Praktika/stazhi si gjyqtar me emërim të përkohshëm, e cila zhvillohet në vitin e tretë të Magjistraturës (vitet 2015-2016), e vendos subjektin në kushtet e ushtrimit të funksionit dhe të qenit në detyrën e gjyqtarit edhe pse me emërim të përkohshëm”.*

11.7 Në vijim të sa më sipër, rezulton se Komisioni, faktin që ankuesja ishte në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese më datë 11.08.2016, e ka konsideruar të barazuar me statusin e magjistrates, pra sikur është emëruar e tillë, ndërkohë që ankuesja është emëruar si magjistrate (gjyqtare) me vendim të KLD-së në datën 20.01.2017. Në këtë optikë, shtrohet për zgjidhje çështja nëse ankuesja është subjekt rivlerësimi sipas parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës. Në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës është përcaktuar rrethi i subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, ku janë përfshirë: të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa në nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 është përcaktuar që subjekt rivlerësimi, sipas këtij ligji, janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b e Kushtetutës. Për të interpretuar parashikimin kushtetues “*të gjithë gjyqtarët*”, Kolegji shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje, sipas të cilit, në kohën e hyrjes në fuqi të dispozitës kushtetuese (ligji nr. 76/2016 ka hyrë në fuqi më datë 11.08.2016), që përcakton rrethin e personave që do t’i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit, referuar edhe jurisprudencës⁷ së Kolegjit, rezulton që ankuesja nuk e kishte fituar statusin e magjistrates/gjyqtares (emëruar në detyrë më datë 20.01.2017), kohë në të cilën sapo ishte diplomuar, rrethanë kjo që nuk i jep asaj titullin e gjyqtares në kuptim të këtij parashikimi. Në nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 parashikohet: *Statusi gëzohet ligjërisht nga një person që sapo emërohet në funksion dhe përfundon me mbarimin e statusit të magjistratit*. Ankuesja është

⁶ Mbledhja e parë që ka konstituuar Këshillin e Lartë Gjyqësor daton më 20.12.2018. Konstituimi është bërë me vendimin nr. 4, datë 20.12.2018, “Për krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor” (marrë nga faqja zyrtare e KLGj-së).

⁷ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 39/2022 (JR), datë 25.10.2022 (E. M. N.).

emëruar nga KLD-ja si “magjistrat” më datë 20.01.2017 dhe është caktuar në funksion më datë 10.02.2017, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Si rrjedhojë e sa më sipër, hyrja në fuqi më datë 11.08.2016 e ndryshimeve kushtetuese, me ligjin nr. 76/2016, e gjejnë ankuesen: (i) të sapodiplomuar (korrik 2016) nga Shkolla e Magjistraturës; (ii) në pritje të emërimit si magjistrat, pra, pa status ligjor të magjistratit në kuptim të ligjit nr. 96/2016.

11.8 Në vijim të sa më sipër, në nenin 35, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, parashikohet: *I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere: a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme; b) është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar; c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6 të nenit 32 të këtij ligji.* Sipas kësaj dispozite, i diplomuari duhet të plotësojë disa kritere ligjore në mënyrë që të emërohet magjistrat, çka nënkupton që ankuesja, duke qenë e sapodiplomuar, nuk ka pasur statusin e magjistratit deri në datën 20.01.2017, që është emëruar e tillë. Ankuesja ka sqaruar në ankim se KLD-ja, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016, duhet të ushtronte kompetencën për emërimin e znj. Hoxholli si magjistrate, por në përputhje me kriteret ligjore të ligjit të mësipërm, ku ndër ta ishte edhe verifikimi paraprak i pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Në zbatim të sa më sipër, KLD-ja ka kryer verifikimet përkatëse për secilin prej magjistratëve të diplomuar në vitin 2016, duke emëruar subjektin si “magjistrat” dhe caktimin më pas në pozicion në gjykatat përkatëse. Sa më sipër, ankuesja pretendon se, pavarësisht se cili organ ka kryer vlerësimin, për aq kohë sa detyra ligjore e këtij organi ishte pikërisht vlerësimi paraprak në tri kriteret, nuk mund t’i nënshtrohej procedurës së rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

11.9 Në vijim të sa më sipër, ankuesja ka parashtruar në ankim se KLD-ja ka marrë informacion nga Shërbimi Informativ Shtetëror (në vijim “ShISh”), në të cilin është cituar se kjo e fundit nuk ka të dhëna që të pengojnë emërimin e saj. Po ashtu, ankuesja ka referuar në ankim se KLD-ja ka marrë informacion edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nga e cila nuk ka rezultuar se ankuesja ka regjistrim pranë organeve tatimore për ushtrim aktiviteti privat, si dhe KLD-ja ka marrë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila ka informuar se nuk ka të dhëna për magjistratët për të cilët është kërkuar informacion nga KLD-ja⁸. Ankuesja pretendon se këto verifikime të pasurisë dhe figurës janë kryer në funksion të parashikimeve sipas pikave 2 deri 6 të nenit 32 të ligjit nr. 96/2016. Shkresat e mësipërme nuk janë administruar në Kolegj, por ankuesja i sjell në vëmendje si procedura verifikimi të kryera nga KLD-ja në përputhje me pjesën III, kreu II, dhe pjesën III, kreu III të ligjit nr. 96/2016.

11.10 Kolegji sjell në vëmendje edhe parashikimin e nenit 160 të ligjit nr. 96/2016, i cili me një rregullim transitor ka marrë përsipër jo vetëm të përcaktojë se cilat janë modalitetet e trajtimit të grupit të magjistratëve të diplomuar në vitin 2016, por ndihmon edhe në interpretimin logjik që i

⁸ Edhe për këto shkresa, relatorja e çështjes ka kërkuar të përcillen në Kolegj nga KLGj-ja, por kjo e fundit ka referuar në shkresën kthim përgjigje drejtuar Kolegjit, se nuk gjenden fizikisht në fondin e tyre.

bëhet nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës. Sipas nenit 160, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon se: *Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj: a) emëron magistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën III, kreu II të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; b) merr vendim për caktimin në pozicione të kandidatëve magistratë të diplomuar në vitin 2016, sipas pjesës III, kreu III të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, rregullohet në mënyrë posaçme emërimi në detyrë dhe caktimi në pozicion i kandidatëve për magistratë të diplomuar në vitin 2016, në të cilët përfshihet edhe ankuesja, duke iu referuar edhe dispozitave që duhen zbatuar për kontrollin e tyre para emërimit në detyrë në pjesën III, krerët II dhe III të ligjit nr. 96/2016. Ky parashikim ligjor tregon se qëllimi i ligjvënësit ka qenë që ky grup kandidatësh për magistratë t'i nënshtroheshin kontrollit, sipas juridiksionit të përgjithshëm, në zbatim të ligjit nr. 96/2016, përpara se ata të emëroheshin në detyrë, ashtu siç edhe është parashikuar për brezat e ardhshëm të kandidatëve për magistratë. Me këtë parashikim ligjor, ndërsa ligjvënësi ka pasur për qëllim që këta magistratë t'i nënshtroheshin juridiksionit të përgjithshëm, ai nuk mund të ketë pasur për qëllim që t'i përfshinte ata në grupin e subjekteve të rivlerësimit që do t'i nënshtroheshin kontrollit, sipas juridiksionit të posaçëm të rivlerësimit, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke vendosur vetëm për këtë grupim që t'i nënshtroheshin një kontrolli të dyfishtë. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se KLD-ja ka respektuar edhe afatet që ka parashikuar ligji nr. 96/2016 për emërimin në detyrë (brenda dy muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji) dhe caktimin në pozicion (brenda tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji) të znj. Semiramis Hoxholli.*

11.11 Kolegji vlerëson se fakti që ankuesja ka depozituar deklaratat, sipas shtojcave të ligjit nr. 84/2016, ashtu si Kolegji ka konkluduar në vendimin nr. 39/2022(JR)⁹, datë 25.10.2022, nuk mund të afektojë interpretimin që i bëhet nenit 179/b të Kushtetutës, interpretim i cili lidhet me vullnetin e ligjvënësit dhe jo me sjelljen procedurale të subjekteve. Kjo shpjegohet edhe me situatën e paqartësisë ligjore të ankueses për mënyrën se si do të interpretohej dispozita dhe statusi i saj, e cila ka marrë masat që mos të ndëshkohet për shkak të një ambiguiteti ligjor, veçanërisht në kohën e dorëzimit të deklaratave, por edhe më pas. Sidoqoftë, kjo rrethanë nuk mund të konsiderohet se përfshin në rrethin e subjekteve që i nënshtrohen rivlerësimit kalimtar ankuesen, përfshirje e cila mbetet një çështje ligjore dhe e paafektuar nga vullneti i palëve në proces.

11.12 Në përfundim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se momenti i emërimit të ankueses si gjyqtare, me vendimin e KLD-së nr. {***}, datë 20.01.2017, është edhe momenti kur ajo ka fituar statusin e magistratit, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, i cili kishte hyrë në fuqi (22.11.2016) para emërimit (20.01.2017) të ankueses si magjistrate dhe caktimi në detyrë i saj me vendimin nr. {***}, datë 10.02.2017, është momenti kur ajo ka filluar ushtrimin e detyrës së gjyqtares. Në konkluzion të këtij arsyetimi, ankuesja nuk e ka pasur statusin e magistratit në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, pasi e ka fituar atë pas hyrjes në fuqi të tyre, si rrjedhojë kontrolli dhe vlerësimi i saj nuk është një proces që duhet t'i nënshtrohet

⁹ Paragrafi 32 i vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit me nr. 39/2022 (JR), datë 25.10.2022.

parashikimeve për procesin e rivlerësimit, por ajo i takonte juridiksionit të zakonshëm, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016. Në vijim të këtij arsytimi, ankuesja nuk mund të jetë edhe subjekt i listës së subjekteve të rivlerësimit të parashikuara në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, pasi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij neni, ajo ishte pa status të magjistratit, të cilin e ka fituar më datë 20.01.2017, me emërimin e saj në detyrë nga KLD-ja. Procesi i verifikimit paraprak të ankueses rezulton se është kryer prej KLD-së, siç përcaktohet në vendimin për emërimin e saj në detyrë dhe se organet e rivlerësimit nuk mund të verifikojnë standardet apo metodologjinë e përdorur për këtë proces nga organi kompetent. Për sa më lart, veprimtaria e Komisionit, si një prej organeve të rivlerësimit, është kryer në tejkalim të juridiksionit të tij kushtetues e ligjor, duke ia nënshtruar çështjen e ankueses procesit të rivlerësimit në kushtet e mungesës së juridiksionit të rivlerësimit.

11.13 Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, i cili përcakton se subjektet e rivlerësimit janë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e Republikës së Shqipërisë, si edhe në interpretim të nenit 136/a, pika 1 e Kushtetutës, dhe nenit 160, pika 2, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016, Kolegji vlerëson se ankuesja duhet t’i nënshtrohet regjimit të përcaktuar nga ky ligj, në zbatim të kontrollit të juridiksionit të përgjithshëm të ushtruar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe të mos i nënshtrohet kontrollit të posaçëm të rivlerësimit nga organet e këtij juridiksioni. Kolegji, duke konkluduar për mungesën e juridiksionit rivlerësues të Komisionit në rastin objekt shqyrtimi, vlerësoi se neni 66 i ligjit nr. 84/2016 mbetet pa efekt, ndaj për këtë arsye, në referim të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, zbatoi dispozitat e ligjit nr. 49/2012, në të cilin parashikimet e nenit 50, germa “d” e tij, u zbatuan për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

12. Në vijim, trajtimi i pretendimeve të tjera të subjektit që lidhen me procesin e rregullt ligjor, si dhe me kontrollin e kriterit të figurës, u konsideruan prej Kolegjit pa relevancë dhe të panevojshme për trajtim, duke qenë se vendimi i Komisionit vlerësohet se duhet të priset për mungesën e juridiksionit të tij për të kryer procesin rivlerësimit ndaj ankueses.
13. Në përfundim, Kolegji arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit nr. 452, datë. 24.09.2021, duhet të priset për sa kohë është marrë nga një organ në tejkalim të kompetencës së tij lëndore, për shkak të mungesës së juridiksionit për trajtimin e çështjes, dhe gjykimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit duhet të pushohet në zbatim të nenit 50, germa “d” e ligjit nr. 49/2012.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në nenin 50, germa “d” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 452, datë 24.09.2021, (korrigjuar me vendimin nr. 452/1, datë 02.12.2021), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, dhe pushimin e gjykimit të çështjes.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 20.11.2024.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi – kundër

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi – kundër

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, anëtarët e trupit gjykues Rezarta Schuetz dhe Sokol Çomo, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kemi votuar kundër vendimit të marrë lidhur me kontrollin e vendimit nr. 452, datë 24.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli.
2. Ne kemi qëndrim të njëjtë me shumicën lidhur me konstatimin e situatës faktike për sa i përket periudhës së studimeve të subjektit të rivlerësimit në Shkollën e Magjistraturës, caktimin e saj për të kryer stazhin profesional, emërimin si magjistrate (gjyqtare) dhe caktimin për ushtrimin e funksionit të gjyqtarës në gjykatën përkatëse. Ne kemi qëndrim të kundërt për sa i përket mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të parashikimeve kushtetuese dhe legjislacionit, që përbën paketën ligjore të reformës në drejtësi, të miratuar pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016.
3. Në mënyrë të përmbledhur, nga situata faktike rezulton se me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9326, datë 20.11.2015, subjekti i rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli është caktuar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. {***}, datë 20.01.2017, Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka emëruar atë magjistrate (gjyqtare), ndërsa me vendimin nr. {***}, datë 10.02.2017, Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka caktuar atë për të ushtruar funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit kryente stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Interpretimi ynë i nenit 179/b të Kushtetutës bëhet në harmoni me nenin 136/a të Kushtetutës, i cili parashikon se: *1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.* Në vlerësimin tonë, për efekt të parashikimit të nenit 21 të ligjit nr. 8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës së stazhit profesional, në vitin 2016 gëzonte të drejta dhe kishte detyrime njësoj si magjistratët e tjerë në detyrë. Këto të drejta dhe detyrime janë gëzuar dhe duhet të përmbusheshin nga subjekti i rivlerësimit.
5. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të gjithë magjistratët në detyrë duhet t’i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*. Për sa cituar më lart, subjekti i rivlerësimit ka gëzuar të gjitha të drejtat e magjistrates gjatë vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës dhe pas përfundimit të saj, por në të njëjtën kohë ajo duhet të përmbushte edhe të gjitha detyrimet që kishin magjistratët në detyrë lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar. Në kuadër të këtyre detyrimeve, rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë plotësuar formularët e parashikuar në shtojcat e ligjit nr. 84/2016, duke treguar në këtë mënyrë se e njihnte detyrimin për t’iu nënshtroar procesit të rivlerësimit kalimtar nga institucionet e rivlerësimit.

6. Në vijim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me të drejtë e ka konsideruar ankuesen Semiramis Hoxholli si subjekt rivlerësimi në kuptim të parashikimeve kushtetuese dhe atyre të ligjit nr. 84/2016.
7. Ne vlerësojmë se interpretimi që Kolegji duhet t'i bënte zbatimit të nenit 179/b të Kushtetutës në çështjen konkrete nuk duhet të ishte literal, por sistematik, në frymën e ndryshimeve kushtetuese dhe parashikimeve të paketës ligjore të vitit 2016, për implementimin e reformës në drejtësi. Ndryshimet kushtetuese, si dhe parashikimet ligjore të kësaj pakete kërkojnë që asnjë magjistrat të mos ushtrojë detyrën pa iu nënshtruar verifikimit të pasurisë dhe figurës. Në vlerësimin tonë, është i pajustificueshëm vlerësimi që ka bërë shumica se subjekti i rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, nuk duhej t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar.
8. Analizën e shumicës për zgjidhjen e çështjes bazuar vetëm në parashikimet e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", e konsiderojmë jo të përshtatshme për zgjidhjen e çështjes, pasi ritheksojmë se ankuesja, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të sipërcituara, gëzonte të drejtat dhe detyrat e magjistratit si pasojë e një ligji tjetër.
9. Kjo mënyrë interpretimi e parashikimeve ligjore, në pajtim me frymën e Kushtetutës, përmbush edhe qëllimin e reformës në drejtësi për të rikthyer besimin e publikut te një sistem drejtësie ku magjistratët ushtrojnë misionin e dhënies së drejtësisë, pasi të jenë verifikuar në lidhje me integritetin e figurës, ligjshmërinë e pasurisë së tyre dhe profesionalizmin.
10. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë kemi kërkuar kontrollin në themel nga Kolegji të vendimit nr. 452, datë 24.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, por një gjë e tillë u pamundësua nga vendimi i shumicës së trupit gjykues, për të cilin ne kemi votuar kundër.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi